



UDHËZUES PRAKTIK 2 – Si të dëgjosh stacione radioamatorësh online?

1) **Dëgjimi i radioamatorëve në Receiverbook.de/map** - me një hartë interaktive e marrësve SDR në të gjithë botën:

1. Hape hartën: <https://www.receiverbook.de/map>
2. Zmadho hartën dhe kliko mbi një marrës (p.sh. SHBA, Brazil, Itali, Gjermani).
3. Kliko **Open WebSDR / OpenWebRX / KiwiSDR** sipas marrësit.
4. Hapet SDR-i i atij stacioni dhe shtyp START.
5. Zgjidh bandën, frekuencën dhe modulimin.
6. Dëgjo stacionet e ndryshme që ai marrës është në gjendje të marrë.

2) **Dëgjimi i radioamatorëve në webSDR.org** - një rrjet global marrësish SDR që mundëson dëgjimin e radioamatorëve në kohë reale, online:

1. Hape faqen: <https://websdr.org>
2. Përdor “Filter band” dhe “region”, ose zgjidh një marrës nga lista (p.sh. Holandë, Gjermani, SHBA), ose scroll në fund të faqes dhe zgjidh marrësin në bazë të vendndodhjes në hartë
3. Në panelin e faqes që hapet aktivizo zërin zakonisht me butonin “audio start” dhe pastaj zgjidh **bandën** (80m, 40m, 20m, VHF, etj.).
4. Lëvizte **frekuencën** duke klikuar në spektrin/waterfall ose duke shtypur frekuencën manualisht.
5. Zgjidh **modulimin**:
 - **LSB** – 160m / 80m / 40m
 - **USB** – 20m / 17m / 15m / 10m / 2m
 - **CW** – sinjale telegrafike Morse
 - **FM** – 2m VHF / 70cm UHF
6. Rregullo volumin dhe dëgjo stacionet e ndryshme që ai marrës është në gjendje të marrë.